

VENDIM
Nr. 18, datë 21.3.2014

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENREL HYDRO” SHPK
NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-et
“ZEREC 1” DHE “ZEREC 2”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, germa “a”, nenit 9 dhe nenit 13, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.3.2014, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “EnRel Hydro” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe të Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “EnRel Hydro” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gerrat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”, është pa plotësuar germa “e” (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë).
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar gerrat “a”, “b” dhe “d”, është pa plotësuar germa “c” (dokumente që vërtetojnë aftësinë dhe/ose mbështetjen financiare të aplikuesit).
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar pjesërisht: janë plotësuar pikat: 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4, 4.1.5, është pa plotësuar pika 4.1.3 (dokumentacioni teknik dhe grafik).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me pikat e sipërcituara, do t’i kërkohej subjektit të depozitohet në ERE brenda afateve të përcaktuara në rregulloren “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të “EnRel Hydro” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Zerec 1” dhe “Zerec 2”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti